



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1607/1 Prot

Tiranë, më 20.11.2019

V E N D I M

Nr.145, datë 20.11.2019

“Mbi përfundimin e verifikimit të kryer në institucionin e qeverisjes vendore Bashkia Ura Vajgurore, të filluar me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, të Komisionerit, në lidhje me evidentimin e rasteve të emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil, në këtë bashki”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenit 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e kryer në njësinë e vetëqeverisjes vendore Bashkia Ura Vajgurore,

VËREJ SE,

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në lidhje me emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, si dhe zbatimin e standardeve ligjore në strukturimin e shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit, me urdhrin nr. 65, datë 12.9.2019, “Për fillimin e procesit të inspektimit në lidhje me rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe verifikimi i zbatimit të standardeve ligjore në strukturimin e

shërbimit civil, si pjesë e rëndësishme e strukturës organizative të institucionit në përputhje me parimet e ligjit për nëpunësin civil”, ka nisur kryesisht procesin e verifikimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (61 bashkitë e vendit), ku përfshihet edhe Bashkia Ura Vajgurore.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në subjekt nga grupi i inspektimit, i autorizuar nga Komisioneri për këtë qëllim. Nga aktet e administruara gjatë inspektimit në subjekt, ka rezultuar se, Bashkia Ura Vajgurore, është e organizuar dhe funksionon në bazë të strukturës dhe organikës të miratuar me Vendim nr. 816 prot., datë 03.04.2019, të Kryetarit të Bashkisë, “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Bashkisë Ura Vajgurore”, e cila është në fuqi edhe në momentin e kryerjes së verifikimit.

Sipas strukturës aktuale, Bashkia Ura Vajgurore, së bashku me njësitë administrative në përbërje të saj, ka gjithsej **54** pozicione pune të vlerësuara si pjesë e shërbimit civil, të cilat sipas kategorive të shërbimit civil klasifikohen: **5** pozicione të kategorisë së mesme drejtuese, **8** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese dhe **41** pozicione të kategorisë ekzekutive.

Aktualisht institucioni, po punon për hartimin e një strukture të re organizative, përgatitja e të cilës është në proces.

Gjatë procesit të verifikimit në subjekt, u konstatua se, të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil të zëna (*52 pozicione*), janë plotësuar nga punonjës të emëruar rregullisht, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ndërsa **2** pozicione pune të shërbimit civil, rezultuan vende të lira të cilat janë shpallur për t’u plotësuar nëpërmjet konkurrimit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, nga ana e institucionit, është vepruar në përputhje me ligjin gjatë veprimtarive administrative të kryera në institutet e ligjit që janë objekt i inspektimit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

- 1.** Të përmyllet procesi i inspektimit të kryer në Bashkinë Ura Vajgurore, pasi nuk janë evidentuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil nga ana e njësisë

përgjegjëse dhe e subjekteve të tjera të ngarkuara me detyra të veçanta për administrimin e shërbimit civil, në këtë institucion.

2. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Ura Vajguore, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Ura Vajguore, Ministria e Brendshme dhe Prefekti i Qarkut Berat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha